



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

Udhëzues për Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës

Prishtinë, mars 2015

Përmbajtja

1. Gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi
2. Raportimi i krimit
3. Mbrojtja e fëmijëve dhe e të miturve
4. E drejta në privatësi
5. E drejta e autorit
6. Mbrojtja e burimeve
7. E drejta për t'u përgjigjur
8. Dallimi ndërmjet përmbajtjes informative dhe reklamave

Hyrje

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) është trup vetërregullues i pavarur i mediave të shkruara të Kosovës, ku bëjnë pjesë gazetat e përditshme, ato periodike, revistat, agjensitë e lajmeve dhe portalet e lajmeve. KMSHK garanton zbatimin e Kodit të Mirësjelljes së Mediave të Shkruara të Kosovës dhe zhvillimin e reputacionit të mediave të shkruara. KMSHK është trup vetërregullues i mediave të shkruara, për të siguruar që këto vlera dhe Kodi i Mediave të Shkruara do të aplikohen në mënyrë të barabartë dhe në të mirë të shoqërisë dhe të qytetarëve të saj.

Kodi i KMSHK-së, i plotësuar në qershor të vitit 2013, është miratuar për herë të parë në vitin 2005. Qëllimi i këtij udhëzuesi është të mbështesë përdorimin e përgjegjshëm të lirisë së fjalës në komunikimin masiv dhe të nxisë diskutimin për etikën profesionale të gazetarisë. Udhëzuesi ofron shpjegime dhe sqarime shtesë të dispozitave të Kodit të KMSHK-së, me qëllim të lehtësimit të zbatimit të tyre në praktikë.

Ky udhëzues, që ka të bëjë me gazetarinë e shkruar dhe atë online, është hartuar posaçërisht për qëllime të vetërregullimit të mediave të shkruara, atyre online si dhe të redaksive të tyre, për të përmirësuar nivelin etik të raportimeve si dhe cilësinë dhe kredibilitetin e gazetarisë. Udhëzuesi i Kodit bazohet në praktikën e mediave të Kosovës dhe atyre ndërkombëtare, në legjislacionin vendës dhe në atë ndërkombëtar.

1. *Gazetari duhet të synojë sigurimin dhe plasimin e informacionit të vërtetë.*
2. *Gazetari është fillimisht përgjegjës para lexuesit, i cili ka të drejtë të dijë çfarë po ndodh në shoqëri.*
3. *Gazetari ka të drejtë të refuzojë detyrat që biejnë ndesh me ligjin, me Kodin e etikës dhe me praktikën e mira të gazetarisë dhe bindjet e tij. Mediat mund të kenë koncepte të ndryshme redaktoriale, por duhet që përpunimi redaktorial i ndonjë shkrimi apo kumtese për media të mos pësojë ndryshim në fakte e as në kontekstin e përdorimit të tyre.*
4. *Kur shfrytëzohet puna e bërë nga mediat e tjera, është e rëndësishme të aplikohen praktikën e mira profesionale që të theksohet burimi.*
5. *Titujt, nëntitujt, paraqitjet në faqen e parë dhe fotografitë duhet të jenë në përputhje me thelbin (substancën) e tekstit.*
6. *Një lajm mund të publikohet në bazë të informacionit të kufizuar. Raportet për atë temë dhe për atë ngjarje duhet të plotësohen kur arrihet informacioni i ri. Lajmet për ngjarjet e reja duhet të plotësohen dhe duhet të korrigjohen.*

UDHËZIME PËR GAZETARINË ONLINE

Këto udhëzime për gazetarinë online janë pjesë përbërëse e Udhëzuesit të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, parimet e të cilit vlejné edhe për gazetarinë online.

Gjithashtu, këto udhëzime kanë të bëjnë me përmbajtjen e komenteve dhe të reagimeve të shkruara nga publiku, të postuara në faqet e portaleve të lajmeve si dhe të agjencive të lajmeve.

1. *Redaksitë mund të zgjedhin që të redaktojnë ose të fshijnë komentet e lexuesve para se të publikohen ose pas publikimit të tyre.*
2. *Redaktimi para publikimit - Redaksia duhet të monitorojë faqen e vet në internet dhe duhet të përpiket të parandalojë publikimin e përmbajtjeve që nxisin, në çfarëdo mënyre, gjuhë denigruese, gjuhë të urrejtjes apo veprime kriminale.*
3. *Redaktimi pas publikimit – redaksitë që publikojnë komente të lexuesve të paredaktuara duhet të ofrojnë mundësinë e kërkesës për heqjen ose redaktimin e komenteve që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, gjuhë denigruese, apo veprime kriminale.*
4. *Redaksia nuk duhet të publikojë në faqen e internetit shkrime apo komente që nxisin ose shkaktajnë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, aftësive të kufizuara fizike apo mendore, orientimit seksual, përkatësisë kombëtare, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose të staturave të tjera.*
5. *Forumet online që kanë të bëjnë me fëmijët dhe me të rinjtë, duhet të monitorohen me kujdes të veçantë.*
6. *Duhet të bëhet një dallim i qartë ndërmjet faqeve të internetit të mediave të shkruara dhe forumeve të rezervuara për tekstet e lexuesve (kolumne, opinione, komente, reagime publike dhe editoriale).*
7. *Para publikimit, përmbajtja e lajmit procedohet nga redaktori apo ekipi redaktorial, sipas rregullave standarde të verifikimit të burimeve. Redaksia është përgjegjëse për atë që publikohet.*

8. *Në forumet e diskutimit, komentet janë fillimisht përgjegjësi e vetë autorëve që i bëjnë ato, por edhe të medias që i menaxhon ato.*
9. *Rekomandohet regjistrimi i lexuesve me identitet për komente.*

Çështja e interesit publik nënkupton publikimin e çdo çështjeje që është në interes të publikut, duke përfshirë edhe çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha degët e pushtetit, me ushtrimin e pushtetit, politikën, ekonominë, sigurinë publike, zbatimin e ligjit, administrimin e drejtësisë, shëndetësinë, interesin shoqëror, interesin e konsumatorëve, ambientin, shkencën, artin e kulturën.

1. Gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi

Mediat nuk duhet të publikojnë asnjë material, i cili, në çfarëdo mënyre përmban apo nxit gjuhë të urrejtjes, gjuhë denigruese apo veprime kriminale. Mediat nuk duhet të publikojnë shkrime që nxisin ose që shkaktojnë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, aftësive të kufizuara fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose staturave të tjera.

2. Raportimi i krimit

Viktimat e krimit, të veprave të ndryshme penale, apo të fatkeqësive të ndryshme, kanë të drejtë në mbrojtjen e identitetit të tyre, përveç rasteve kur opinionin ka nevojë të kuptojë më mirë për ngjarjen në fjalë. Nëse hetimi, ngritja e aktakuzës, apo dënimi nga gjykata, ka qenë temë e ndonjë shkrimi apo lajmi, atëherë çështja duhet të ndiqet deri në fund.

Gazetari, në mënyrë të veçantë, duhet të jetë i kujdesshëm të mos e publikojë identitetin e ndonjë personi të mitur në rast se ata janë pjesëmarrës në krime. Anëtarëve të familjes, apo njerëzve të tjerë të personit të dyshuar apo të akuzuar për krime, nuk duhet t'u zbulohet identiteti, përveç nëse në çfarëdo mënyre janë pjesëmarrës në veprimet penale që trajtohen.

Kur raportohet për krimin, për të dyshuarin nuk lejohet të përmendet përkatësia fetare, përkatësia etnike, apo përkatësi të tjera, përveç nëse ai informacion mund të jetë i rëndësishëm që opinionin ta kuptojë ngjarjen më mirë. Posaçërisht duhet pasur parasysh që nuk lejohet përmendja e përkatësisë etnike, përkatësisë fetare, dhe përkatësive të tjera të grupeve pakicë. Mediat e kanë për detyrë të përcjellin deri në fund ecurinë e proceseve gjyqësore për të cilat kanë filluar të shkruajnë.

3. Mbrojtja e fëmijëve dhe e të miturve

Mediat janë të obliguara të veprojnë në harmoni me parimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe ligjet e Kosovës. Mediat duhet të kenë pëlqimin e prindit ose të kujdestarit, për të intervistuar, xhiruar, apo fotografuar fëmijët nën moshën 18 vjeç.

Mediat nuk duhet të identifikojnë fëmijët nën moshën 18 vjeç, nëse ata janë të përzier në vepra penale, qoftë si viktimë, dëshmitarë apo si të pandehur. Fëmijët nuk duhet të fotografohen, të xhirohen, të intervistohen dhe të shqetësohen në asnjë mënyrë, në shkollë apo në afërsi të shkollës, pa lejen e drejtuesve të shkollës. Nuk lejohet identifikimi i fëmijëve në të gjitha rastet e lartpërmendura.

4. E drejta në privatësi

Mediat nuk duhet të raportojnë për jetën private të ndonjë personi, përveç në rastet kur për këtë ekziston interesi publik*. Raportimi për personat publikë, në parim, është i lirë për çdo sferë të veprimtarisë personale dhe profesionale të tyre, nëse për këtë ekziston interesi publik*. Mediat nuk mund të bëjnë fotografi të njerëzve në ambiente private, pa lejen paraprake të tyre, përveç nëse për këtë ekziston interesi publik*.

5. E drejta e autorit

Mediat lejohen t'i referohen vetëm informatës thelbësore të shkrimit original nëse nxjerrin një artikull të ri, me kusht që të japin referencë të qartë për median të cilës i referohen. Mediat nuk duhet të publikojnë në tërësi materialin e publikuar nga publikuesit e tjerë, pa leje paraprake të publikuesit të parë.

Ky rregull bën përjashtim atëherë kur publikuesi parasheh me klauzolë, ose në formë tjetër të dukshme, që materiali i publikuar mund të ripublikohet pa kërkim të lejes.

Mediat nuk duhet të marrin fotografi dhe video nga mediat tjera pa leje paraprake të publikuesit të parë.

Në të gjitha rastet e ripublikimit, mediat obligohen të citojnë publikuesin e parë të materialit.

6. Mbrojtja e burimeve

Gazetarët janë të obliguar të mbrojnë identitetin e burimeve të tyre, përveç nëse gjykata nuk e kërkon të kundërtën. Gazetarët, në asnjë mënyrë, nuk janë të detyruar të zbulojnë burimet e tyre në rastet që kanë të bëjnë me ankesat për shpifje dhe fyerje.

Gjykata mund të kërkojë nga i padituri për një vepër të shpifjes apo të fyerjes që të zbulojë informacionin relevant për përcaktimin e vërtetësisë së materialit të publikuar, por pa e identifikuar burimin.

Trillimi i burimit anonim paraqet shkelje të rëndë. Gazetari nuk duhet të fshehtë informacione të rëndësishme që mund të ndikojnë në përmbajtjen e informatës së botuar. Nëse i intervistuari nuk dëshiron që t'i zbulohet identiteti, atëherë redaksia merr përgjegjësinë eventuale.

Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose të një deklaratë të pavërtetë, për të cilën publikuesi e di, ose është dashur të dijë, se ai fakt ose ajo deklaratë është e pavërtetë dhe kuptimi i së cilës e dëmton reputacionin e një personi tjetër.

Fyerja nënkupton deklarinimin, sjelljen, publikimin e deklaratës së drejtuar ndaj ndonjë personi tjetër dhe e cila është nënçmuese.

7. E drejta për t'u përgjigjur

Nëse media konstaton se ka publikuar shkrimin që përmban fakte të shtrembëruara esencialisht, duhet që në afatin sa më të shkurtër të publikojë korrigjimin. Nëse media konstaton se ka publikuar shkrim të gabueshëm, dhe me atë rast ka rrezikuar reputacionin e ndonjë personi apo të ndonjë institucioni, duhet të kërkojë falje në afatin sa më të shkurtër.

Media duhet ta bëjë publikimin e korrigjimit, reagimit, ose përgënjeshttrimin, në një vend të dukshëm në faqet e gazetës, ose në faqen e caktuar nga redaksia për botimin e tyre.

Nëse përgjigjia ose reagimi nuk është i përshtatshëm për botim, ndryshimet që kërkon redaksia duhet të diskutohen me dërguesin. Nëse as pas kësaj nuk mund të arrihet marrëveshje, atëherë është e këshillueshme të publikohet përmbajtja thelbësore e përgjigjes, e pastruar nga pjesët e papërshtatshme (fyerjet, shpifjet, etj.) që biejnë ndesh me Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës.

Nëse nuk është e mundur që në të njëjtin shkrim të botohen prononcimet e të gjitha palëve, atëherë palës që nuk i është botuar qëndrimi për arsye të ndryshme, duhet t'i jepet sa më parë mundësia e përgjigjes. Media duhet të botojë edhe komentimin e palës tjetër.

8. Dallimi ndërmjet përmbajtjes informative dhe reklamave

Reklamata në faqet e mediave të shkruara dhe ato online, të cilat i paguajnë sponsorët, duhet patjetër të dallohen qartazi nga përmbajtjet informative dhe duhet të jenë të publikuara në atë mënyrë që lexuesi t'i dallojë si të tilla.

Mediat dhe gazetarët duhet të kenë kujdes të veçantë që raportimi profesional të jetë i ndarë nga marketingu, në mënyrë që të mënjanohet ndonjë konflikt interesi.